



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

VETËVLERËSIMI I NJOHURIVE

TEST I KOMBINUAR

nga shkencat natyrore dhe shoqërore

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST


- Testi që do të zgjidhni do t'ju ndihmojë të vlerësoni sa keni zotëruar materialin e mësuar.
- Para teje është testi i kombinuar nga shkencat natyrore dhe shoqërore me detyra nga lënda e biologjisë, historisë, gjeografisë, fizikës dhe kimisë. Testin që duhesh ta zgjidhësh i ka 20 detyra, ndërsa për punë janë paraparë 60 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes dhe mendo se çfarë kërkohet në këtë pyetje.
- Me kujdes lexo tekstin e secilës detyre, sepse në të janë dhënë sqarime se në cilën mënyrë duhesh të përgjigjesh. Gjatë punës nuk mund të përdorësh celularin.

Ju dëshirojmë sukses në provim!

* Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено умножавати нити јавно објављивати без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.

1. Në cilën prej pozicioneve të shënuara magneti tërheq më fort sferën prej hekuri?

- a) pozicioni 1
- b) pozicioni 2
- c) pozicioni 3
- d) Tërheqja është njësoj në të gjitha pozicionet.



Rretho përgjigjen e saktë.

2. Fëmiu ka hedhur topin vertikalisht përpjetë dhe pas një kohe e ka kapur. Si ka lëvizur topi në atë moment?

- a) Ka lëvizur njëtrajtësisht deri sa ka shkuar lartë.
- b) Ka lëvizur njëtrajtësisht deri sa ka lëvizur te poshtë.
- c) Ka lëvizur njëtrajtësisht gjatë tërë kohës.
- d) Nuk ka mundur të lëviz njëtrajtësisht për arsye se kthehet në vendin nga i cili është nisur.


Rretho përgjigjen e saktë.

3. Në poçin elektrik shkruan 220 V / 80 W. Sa energji elektrike harxhon ky poç nëse kyçet 8 orë?

Përgjigja: _____ Wh

4. Sferën e lëshojmë të oscilojë pandërprerë mes pikës A dhe C. Çka mund të thuash për shpejtësinë e saj?

- a) Shpejtësia më e madhe është në pikën A.
- b) Shpejtësia më e madhe në pikën B.
- c) Shpejtësia më e madhe në pikën C.
- d) Në pikën B shpejtësia është zero.



Rretho përgjigjen e saktë .

5. Çka është substancë e pastërt e thjeshë?

- a) oksigjeni
- b) ajri
- c) mjegulla
- d) tymi

Rretho përgjigjen e saktë.

6. Barazimi i filluar i reaksionit kimik të djegjes së propanit:



Me çfarë shenja dhe koeficiente duhet paraqitur reaksionet prodhuese?

- a) $3\text{CO}_2 + 4\text{H}_2\text{O}$
- b) $\text{C}_3 + 4\text{H}_2$
- c) $3\text{CH}_4 + 4\text{H}_2$
- d) $3\text{CO}_2 + 8\text{H}_2\text{O}$

Rretho përgjigjen e saktë.

7. Në reaksionin e oksidit të sulfurit(IV) dhe hidroksidit të natriumit formohen:

- a) Na_2SO_3 dhe H_2O
- b) Na_2SO_3 dhe H_2
- c) Na_2SO_4 dhe H_2O
- d) Na_2SO_4 dhe H_2

Rretho përgjigjen e saktë.

8. Nrdëlidhi llojin e qenies së gjallë së cilës mbretëri i takon.

Shkruaj shkronjën përkatëse në vizat e zbrazëta.

- | | |
|----------------------------|------------------------------|
| 1. ___ elefanti afrikan | a) mbretëria e monotremateve |
| 2. ___ ameba | b) mbretëria e protistëve |
| 3. ___ bakteria salmonella | c) mbretëria e kerpudhave |
| 4. ___ dushkaja | d) mbretëria e bimëve |
| | e) mbretëria e shtazëve |

9. Provokues i një sëmundjeje të sistemit nervor është virusi. Cila është ajo sëmundje?

- a) epilepsia
- b) tërbimi
- c) migrena
- d) pika në tru

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

10. Cila nga gjëndrat e përmendura sekreton hormonin e rritjes?

- a) farorët
- b) gjëndrra kraharore
- c) gjëndrra parambrojtëse
- d) hipofiza

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

11. Kur toka nuk punohet për një kohë të gjatë hapsirën do ta zënë biocenozat të cilat kanë ekzistuar në atë hapsirë para se njeriu të ketë filluar për ta punuar tokën:

- a) introdukcioni;
- b) adaptimi;
- c) migracioni;
- d) sukcesioni.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

12. Çfarë gjendet në çdo kokërr poleni?

- a) pluhuri i polenit
- b) peri i pluhurit
- c) qesja e polenit
- d) qeliza e gjinisë mashkullore

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

13. Në hartat gjeografike, metodat e izohipsave, ngjyrave, hijëzimit dhe shrafurave paraqesin:

- a) fabrikat, banjat, shpellat, minierat, hidrocentralet dhe qytetet;
- b) rrugët, hekurudhat, kufijtë, rrymat detare, urat dhe tunelet;
- c) pyjet, vreshtat, livadhet, moçalet dhe llojet e tokave;
- d) relievin e sipërfaqes së Tokës, relievin e bazenit të oqeanëve, detërave dhe liqeneve.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

14. Si quhet era e cila fryn në Serbin lindore, Vojvodin dhe Shumadi?

- a) bura
- b) era e vardarit
- c) koshava
- d) era e moravës

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

15. Lëvizja mekanike e popullsisë përfshin:

- a) natalitetin;
- b) mortalitetin;
- c) migrimet;
- d) fertilitetin.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

16. Lumin ndërlidhe me grykën në të cilën rrjedh
Shkruaj shkronjën përkatëse në vizat e zbrazëta.

- | | |
|-------------------------|-----------------------|
| 1. ___ Morava Jugore | a) gryka e Kaçanikut |
| 2. ___ Bistrica e Pejës | b) gryka e Bagrdanit |
| 3. ___ Lepenci | c) gryka e Gërdelicës |
| 4. ___ Morava e Madhe | d) gryka e Gjedapit |
| | e) gryka e Rugovës |

17. Cila ideologji ka lavdëruar Gjermanët, kurse ka nënçmuar popujt e tjerë, zbatimi i së cilës gjatë luftës së II botërore ka çuar në vdekje disa miliona njerëz?

- a) Protestantizmi
- b) Liberalizmi
- c) Nacizmi
- d) Konzervatizmi

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

18. Si është quajtur dinastia më e rëndësishme mesjetare serbe?

- a) Obiliq
- b) Obrenoviq
- c) Karagjorgjeviq
- d) Nemanjiq

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

19. Shiko foton dhe përgjigju në pyetjen:

Në pankarta janë shkruar parolat: „Kërkojmë të drejtat e barabarta – menjëher” dhe „Të drejta qytetare + punësim = liri”.

Cila dukuri historike është paraqitur në fotografi?

- a) Lufta për të drejtat themelore të njeriut
- b) Lufta e dhunshme për të drejtat e njeriut
- c) Përkrahje fashizmit
- d) Demonstrata antiluftarake

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.



20. Cili shtet ka lindur gjatë luftërave ballkanike të vitit 1912?

- a) Bullgaria;
- b) Maqedonia;
- c) Shqipëria;
- d) Bosnja dhe Hercegovina.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.